



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1584 Prot.

Durrës, më 25.10.2022

VENDIM

Nr. 60 Datë 25/10 /2022

PËR
NJË NDRYSHIM NË REGJISTRIN E PARASHIKIMEVE TË PROÇEDURAVE TË
PROKURIMIT PUBLIK, PËR VITIN KALENDARIK 2022"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar regjistrin të parashikimit të procedurave të prokurimeve publike për vitin kalendarik 2022, miratuar me vendim të Bordit të Administrimit Nr.7 datë 18.02.2022 me Nr. 308/5 Prot datë 18.02.2022, shkresës Nr. 5164/1 Prot, datë 02.08.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me objekt "Njoftim mbi projektet e miratuara, për vitin akademik 2022-2023", Vendimit Nr. 52 datë 08.09.2022 të Senatit Akademik, Vendimit Nr. 42 datë 14.09.2022 të Bordit të Administrimit, kalendarit të aktiviteteve për realizimin e projektit të Ndërkombëtarizimit me temë Diplomë e dyfishtë në ciklin e tretë të Studimeve, Doktoratë në Shkenca Edukimi në "Administrim Publik" dhe në " Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik", bazuar në kërkesat me Nr. 1486 Prot , 1486/1 Prot., datë 11.10.2022 për hapjen e procedurave të prokurimit për blerjen e librave në kuadër të projektit të Ndërkombëtarizimit si dhe në Kërkesën me Nr. 1553 Prot. datë 24.10.2022 të Administratorit " Për një ndryshim në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin kalendarik 2022", Senati Akademik në mbledhjen e datës 25.10.2022,

VENDOSI:

1. Ti propozojë Bordit të Administrimit ndryshimin e objektit të prokurimit në regjistrin e parashikimit të prokurimit publik të vitit kalendarik 2022 duke shtuar në zërin me objekt "Blerje Librash për Biblotekën" dhe blerjen e librave në kuadër të projektit të Ndërkombëtarizimit me burime financimi të ndara përkatësisht :
 - Blerje libra për fondin e Biblotekës me vlerë 5.000.000 (pesë million) lekë pa Tvsh dhe Burim Financimi nga të Ardhurat e Institucionit ;
 - Blerje Libra në kuadër të projektit të ndërkombëtarizimit për programet e studimit për vitin akademik 2022-2023 me vlerë 15.000.000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë pa Tvsh dhe Burim Financimi nga të Ardhurat e Buxhetit të Shtetit.
2. Lloji i procedurës së prokurimit të jetë: "Procedurë e hapur".

Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.

KRYETAR

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI